



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 574 Prot.

Tiranë, më datë 05.03.2020

VENDIM

Nr. 93, datë 05.03.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, VKM NR. 687, datë 23.10.2019 “Për miratimin e zonës së mbrojtur "A" të qytetit të Elbasanit dhe të planit të ruajtjes, mbrojtjes dhe administrimit të saj”, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 05.03.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Rikonstruksion bodrumi nëntokë dhe rindërtimi i shtëpisë së rrënuar dy katëshe”, Elbasan, Lagjia “Kala”, zona kadastrale 8524, Nr. pasurie 16/56, në pronësi dhe me zhvillues z. Andi Bejleri, hartuar nga subjekt i licencuar në restaurim z.Fatjon Saliu;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

